



Nr. 130/1 prot.

Elbasan, më 12.12.2024

Nr. 72 prot.

Tiranë, më 12.12.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

DHE

TERRE DES HOMMES

PËR

Zbatimin e projektit "Të Rinjtë, të Drejtat dhe Drejtësia"



Preambul:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Organizata Terre des hommes, në vijim të quajtura *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të respektimit të drejtave të njeriut;

Duke marrë në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe kërkesat për implementimin e suksesshëm të tyre;

Duke synuar zbatimin efektiv të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe për të mbështetur riintegrimin e tyre në shoqëri;

Duke konsideruar se për të kontribuar në respektimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht të fëmijëve në konflikt me ligjin është e domosdoshme *riintegrimi dhe përfshirja sociale e të miturve në konflikt me ligjin*;

Duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të përmirësimit të drejtësisë penale për të mitur;

Duke njohur faktin se Organizata “Terre des hommes” ka ngritur dhe po zbaton një program të drejtësisë për të mitur, pjesë e të cilit është projekti “*Të Rinjtë, Të Drejtat dhe Drejtësia*”;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur *Marrëveshje*.



Neni 1

Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e angazhimeve ndërmjet palëve:

- i. Mbështetja e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin për të cilët zbatohet masa e shmangies nga procedurat penale, bazuar në vendimin e Prokurorisë.
- ii. Hartimin e planeve individuale për secilin fëmijë në bazë të nevojave të tyre specifike dhe situatës së familjeve;
- iii. Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë, koordinatores së viktimave, punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe organizatës Terre des hommes për zbatimin efektiv të masës së shmangies dhe riintegrimin e qëndrueshëm të fëmijëve;
- iv. Mbështetjen për riintegrimin në shoqëri të fëmijëve në konflikt me ligjin me masë shamngie si dhe familjeve të tyre, duke përfshirë trajnime profesionale, aktivitete jashtëshkollore dhe mundësi punësimi.

Neni 2

Objekti

Palët në përputhje me prioritet e veprimtarisë së tyre bien dakord të bashkëpunojnë për:

- i. Hartimin dhe zbatimin e planeve individuale për fëmijët që përfitojnë masën e shmangies, në bashkëpunim me punonjësën e mbrojtjes së fëmijëve dhe koordinatoren e viktimave pranë Prokurorisë;
- ii. Referimin pranë Terre des hommes nga Prokuroria, të rasteve të fëmijëve të grupmoshës 14-18 vjeç për të cilët zbatohet masa e shmangies nga procedurat penale, për përfitimin e shërbimeve të përshtatura me qëllim lehtësimin e integritetit të tyre në shoqëri.
- iii. Shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit midis kordinatores së viktimave dhe stafit të Terre des hommes mbi rastet e referuara.



- iv. Organizimin e takimeve periodike midis përfaqësuesve të Prokurorisë dhe stafit të Terre des hommes, për të diskutuar mbarëvajtjen e punës mbi rastet e referuara.
- v. Monitorimin dhe vlerësimin e rasteve të referuara për të garantuar qëndrueshmërinë e riintegritimit.

Neni 3

Territori i zbatimit të Marrëveshjes

Zbatimi i kësaj Marrëveshje shtrihet në të gjitha qytetet të cilat janë në Juridiksionin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Neni 4

Detyrimet e Palëve

Secila nga Palët sipas fushës së veprimtarisë së tyre kanë detyrimet e mëposhtme:

a) Prokuroria ka detyrimin që:

- i. të referojë tek Terre des hommes rastet e personave të grup-moshës 14-18 vjeç për të cilët zbatohet masa e shmangies nga përgjegjësia penale me vendim të prokurorit, sipas vlerësimit të prokurorit të çështjes.
- ii. të vendosë në dispozicion të stafit të Terre des hommes të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me rastet e referuara, pas aplikimit të masë së shmangies nga përgjegjësia penale.
- iii. monitoron dhe vlerëson zbatimin e masave në bashkëpunim me Terre des hommes.

b) organizata Terre des hommes ka detyrimin që:

- i. të përfshihet aktivisht në ofrimin e shërbimeve ririntegruese sipas nevojave të rastit të referuar nga Prokuroria, të cilat evidentohen pas vlerësimit të thelluar të rastit.
- ii. të informojë, me shkrim dhe/ose nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese në mënyrë periodike, Prokurorinë në lidhje me mbarëvajtjen/ecurinë e rasteve.



- iii. të sigurojë në çdo rast menaxhimin dhe administrimin e të dhënave personale të të miturve në konflikt me ligjin të referuar nga Prokuroria sipas parashikimeve dhe në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale Nr.9887, datë 10.3.2008, Politikën e Mbrojtjes së të dhënave Personale të Tdh-së, Procedurën e Standarteve Minimale mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Tdh-së si dhe Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve.
- iv. të ruajë sekretin hetimor për rrethanat, aktet dhe të dhënat e çështjes që vihet në dijeni për shkak të referimit të rastit, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale dhe KDPM.

Neni 5

Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të Marrëveshjes nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese të dedikuara për raste specifike si dhe paraqitjes së raporteve periodike me shkrim pranë titullarëve të Palëve.
2. Raporti periodik përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të Marrëveshjes, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 6

Komunikimi mes Palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore, takime të drejtpërdrejta mes stafeve si dhe në raste të veçanta edhe në rrugë elektronike.
2. Palët caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e kërkesave të tyre. Për prokurorinë person kontakti do të jetë Koordinatori për Subjektet me Status të Posaçëm.
3. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.



Neni 7

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje zbatohet për periudhën **Dhjetor 2024 – Dhjetor 2025**

Neni 8

Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 10

Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga projekti i Terre des hommes.

Neni 11

Hyrja në Fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi më datë **20 Dhjetor 2024** dhe mund të publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



Nënshkruar në Tiranë, më 12 . 12 . 2024.

PËR

**Prokurorinë pranë Gjykatës
së Shkallës së Parë të Juridiksionit
të Përgjithshëm Elbasan**

DREJTUES I PROKURORISË

Kreshnik Ajazi



PËR

Terre des hommes

DREJTOR KOMBËTAR

Enkelejda Kallçiu

